



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____

Data: _____

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 6, pika 6, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) Fotografi në Departamenti për Shërbime me Konsumator dhe Media, në Ndërmarrjen Publike Banesore –SH.A me seli në Prishtinë.

Orari: I plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga Menaxheri i Divizionit të zyrës së Mediave, i cili është në kuadër të Departamentit për Shërbime me Konsumator dhe Media;
- Ndhmon Menaxherin dhe bashkëpunon me zyrtarët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës, për përmbushjen e objektivave të Dep. të Shërbimeve më Konsumatorë & Media në veçanti dhe NPB në përgjithësi.
- Të jetë në gjendje të siguroj fotografi profesionale, të bëjë montazh, video dhe të siguroj material të mjaftueshëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e PR-it dhe Marketingut në Divizionin e Mediave;

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike

- Organizon procesin e marrjes së fotografive dhe videove që nga fillimi deri në përfundim të ngjarjeve, punëve, eventeve etj., të caktuara nga NPB;
- Të përcjellë me fotografi dhe video gjendjen e ndërtesave para dhe pas renovimeve dhe investimeve, të cilat janë pjesë e projektit për Renovim dhe Mirëmbajtje me NPB;
- Merrë pjesë në takimet e Divizionit për Media si dhe organizon, propozon dhe ndihmon në shtrirje të strategjisë së marketingut dhe PR-it në rrjete sociale;
- Është përgjegjës për sigurimin e fotografimeve profesionale dhe videove që ndihmojnë në zhvillimin e Pr-it dhe Marketingut të NPB-së;
- Është përgjegjës për ruajtjen e pajisjeve të punës që kanë të bëjnë me Divizionin e Mediave;
- Mban evidencë për të gjitha punët të cilat realizohen nga Divizioni i Mediave dhe i dorëzon tek Departamenti i Shërbimeve me Konsumatorë dhe Media për arkivim;

Kualifikimet:

- Të këtë të përfunduar shkollën e mesme profesionale;
- Bartësi i vendit të punës duhet të këtë së paku 2 vjet përvojë punë në pozitën e kërkuar;
- Të këtë aftësi kompjuterike të programeve Microsoft Office si dhe në programet për editim të fotove dhe videove, në veçanti në programet ADOBE COLLECTION ;
- Të njoh pajisjet/aparatet fotografike dhe vizuale
- Të këtë njohuri të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë të kryer kurse apo trajnime për fotograf ose dizajn grafik;

Kualifikimet tjera:

- Çertifikime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të këtë njohuri rreth punës dhe mirëmbajtjes së rrjeteve sociale;

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën *Fotograf në Departamenti për Shërbime me Konsumator dhe Media* duhet t'i dorëzoj këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejës së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, rruga "Xhevdet Doda",nr.32, Prishtinë** ose përmes e-mailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 08 nëntor 2019– 22 nëntor 2019 ora 16:00.**